



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-050

Prishtinë, më 13 shkurt 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 13 SHKURT 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga Grupet Parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Ismet Beqiri, në emër të Grupi parlamentar të LDK-së, shfaqti pakënaqësi lidhur me heqjen e fotografisë së ish - presidentit Ibrahim Rugova, nga salla e Kuvendit C-301.

Lidhur për këtë çështje diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, Ismet Beqiri dhe Adem Grabovci, kryetarë të grupeve parlamentare, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Adem Grabovci propozoi që Kryesia e Kuvendit të mbajë një minutë heshtje për nderë të viktimave që humbën jetën nga fatkeqësia natyrore në fshatin Restelicë, komuna e Dragashit.

Kryesia me një minutë heshtje nderoi viktimat që humbën jetën nga fatkeqësia natyrore në fshatin Restelicë, komuna e Dragashit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 shkurt 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2012 dhe
5. Kërkesa (gojore) e presidentes dhe kryeministrit të Republikës së Kosovës për mbajtjen e një seance solemne për shënimin e katër vjetorit - 17 Shkurtit 2012, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 shkurt 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 shkurt 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit, të mbahet të mërkurën, më 15 shkurt 2012, me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arkivat,
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës,
8. Shqyrtimi i Propozim-programit të punës së Kuvendit, për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Vendimi i Presidentes lidhur me kthimin e Ligjit për Policinë e Kosovës për rishqyrtim

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vendimin e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që ta shqyrtojë vendimin e presidentes lidhur me kthimin e Ligjit për Policinë e Kosovës për rishqyrtim dhe Kuvendit brenda dy javë pune t'ia paraqet raportin me rekomandime.

2. Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe peticione për debat parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës

Kryesia vendosi që rekomandimi i cekur më lartë, të radhitet për mbledhjen plenare të radhës.

3. Kërkesa e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve

Kryesia vendosi që kërkesën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve, ta radhisë në rend dite për mbledhjen plenare, më 15 shkurt 2012.

4. Mocion i Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje” për të konstatuar zbatimin e Rregullores së Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me mocionin e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, që ta shqyrtojë mocionin e Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, për të konstatuar zbatimin e Rregullores së Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqet raportin me rekomandime.

Pikat shtesë:

1. Propozim-programi i punës së Kuvendit, për vitin 2012

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim- programin e punës së Kuvendit, për vitin 2012, vendosi që atë ta radhisë në rend dite për mbledhjen plenare më 15 shkurt 2012.

2. Kërkesa e presidentes dhe e kryeministrit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e një seance solemne, për shënimin 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur kërkesën e cekur më lart, vendosi që Kuvendi të mbajë një seancë solemne, më 16 shkurt 2012, në orën 14:00.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:55** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale